




Quality Endurance Passion

## Gulf Super Brake Fluid DOT 4

### ALKOOL FRENASH



#### Gulf Super Brake Fluid DOT 4

**Gulf Super Brake Fluid DOT 4** është frenash me performancë të lartë, i prodhuar për përdorim në disqe, tambur dhe sistemet kundra bllokimit të frenave (ABS) për çdo automjet tregtar, makinë për pasagjerë dhe motorë që përdoren në kushte nga më të vështirat deri tek ato mesataret, të cilat kanë nevojë për alkool të tipit DOT 4. **Gulf Brake Fluid DOT 4**, për shkak të pikës më të lartë të saj vlimi, zbut efektet e përthithjes së lagështirës dhe siguron një frenim eficient.

**Gulf Super Brake Fluid DOT 4** përmban përbërës frenues ndaj oksidimit dhe korrozionit për t'i rezistuar oksidimit në temperaturë të lartë, gjë që haset në sistemin e frenave në disqe dhe ofron mbrojtje të lartë kundër korrozionit të komponentëve metalikë në sistemin e frenave. Pika e lartë e vlimi e **Gulf Super Brake Fluid DOT 4** redukton impaktin e përthithjes së lagështirës në momentin e ndezjes dhe ofron performancë eficiente të frenave.

Qëndrueshmëria e lartë oksiduese i reziston oksidimit në temperatura të larta që ndeshen në sistemet e frenimit tek disqet; ka stabilitet të lartë në temperatura të larta dhe rrjedhshmëri në temperaturë të ulët gjë që siguron funksionimin pa probleme. Frenimi efektiv ndaj gërryrjes ofron mbrojtje afatgjatë kundër korrozionit të komponentëve metalikë të sistemit të frenave, rrëshqitshmëri dhe mbrojtje të sistemit.

**Gulf Super Brake Fluid DOT 4** është në përputhje me të gjithë guarnicionet dhe metalet e përdorura në sistemet konvencionale të frenimit që kanë nevojë për alkool frenash poli glikol.

**Gulf Super Brake Fluid DOT 4** rekomandohet për sistemet hidraulike të frenave tek makinat, motorët dhe mjetet tregtare ku DOT 4 është lloji i specifikuar i alkoolit të frenave. Gjithashtu për frenat me disk dhe tambur, përfshirë automjetet moderne të pajisura me ABS që kërkojnë alkool të cilësisë DOT 4; për të përmirësuar performancën e frenimit, ky alkool mund të përdoret edhe në sistemet hidraulike të frenave të automjeteve që kërkojnë alkool të cilësisë DOT 3 ose SAE J 1703 si dhe në sistemet hidraulike të friksionit që kërkojnë alkool të kësaj cilësie.

**Gulf Super Brake Fluid DOT 4** nuk duhet të përdoret asnjëherë në vend të alkoolit të frenave me bazë silikoni apo të përzihet me të (DOT 5) dhe as nuk duhet të përdoret kur kërkohet alkool DOT 5.1. Të gjithë alkoolët e frenave duhet të mbahen në vend të pastër dhe të eë thatë. Papastërtia ose uji i ndotur mund të ndikojë në performancën e alkoolit të frenave dhe mund të shkaktojë prishje të sistemit të frenimit. Alkooli i frenave mund të ndikojë në lyerjen e makinës, kështu që tregoni kujdes nëse ju derdhet duke e hequr menjëherë pa e fërkuar.



Quality Endurance Passion

## Gulf Super Brake Fluid DOT 4

### SPECIFIKIMET



*Plotëson specifikimet e: FMVSS 116 DOT 4,  
SAE J 1703, ISO 4925*

Karakteristika	Metodat e testit:	Vlerat tipike:
Densiteti @ 15°C	ASTM D4052	1060 kg/m <sup>3</sup>
Viskoziteti Kinematik @ 40°C	FMVSS 116	1200 mm <sup>2</sup> /s (cSt)
Viskoziteti Kinematik @ 100°C	FMVSS 116	2.3 mm <sup>2</sup> /s (cSt)
Equilibrium Reflux Boiling Point (ERBP)	FMVSS 116	267°C
Wet Equilibrium Reflux Boiling Point	FMVSS 116	167°C
Vlera pH	FMVSS 116	7.3
Kodi i Produktit: 6404	Data e lëshimit: 25/06/2012	Data e zëvendësimit: 02/12/2011
		Rishikimi nr: 01